



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

Ilir META



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT  
TË MBIKËQYRJES FINANCIARE PËR VITIN 2014

**Kuvendi i Shqipërisë,**

- Duke njohur rolin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare, në Republikën e Shqipërisë;
- Duke njohur kontributin e tij në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së këtyre tregjeve;
- Duke njohur rolin e këtij Autoriteti për t'i siguruar Kuvendit, drejtuesve të institucioneve shtetërore dhe publikut në përgjithësi një informacion cilësor e profesional mbi këto tregje;
- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë Autoritet, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

**Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në drejtim të:**

- Forcimit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të AMF-së në përmbushje të objektivave të saj, nëpërmjet forcimit të pavarësisë, llogaridhënies dhe të përgjegjshmërisë;
- Përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit ligjor dhe nënligjor, në përputhje me parimet ndërkombëtare dhe direktivat europiane;
- Mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, duke garantuar në të njëjtën kohë zhvillimin dhe sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur;
- Hartimit të metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus riskun për tregun e sigurimeve dhe krijimin e platformës bazë për të bërë të mundur tarifimin me bazë riskun;
- Plotësimit të detyrimeve të shoqërive të sigurimit ndaj Byrosë për financimin e Fondit të Kompensimit për pagesat e prapambetura;
- Forcimit të bashkëpunimit me organizmat dhe institucionet, kombëtare dhe ndërkombëtare, në tërheqjen e politikave më të mira dhe asistencës teknike të nevojshme.

**Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për vitin 2015, të angazhohet në këto drejtime:**

- Të ndërmarrë ndryshime strukturore dhe organizative të nevojshme për t'iu përshtatur prirjeve të zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje dhe sfidave që shtrohen për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tyre.

- Të paraqesë, brenda muajit shtator 2015, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, amendimet ligjore për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike, si dhe të vijojë zbatimin e masave stabilizuese në tregun e sigurimeve dhe vendosjes së standardeve të mirëpërcaktuara, në lidhje me rezervat minimale, nivelin e likuiditetit, mjaftueshmërisë së kapitalit, praktikave të provigjonimit dhe sidomos përmirësimin e raportit dëme/prime.

- Të forcojë kapacitetet mbikëqyrëse, duke specializuar aftësitë në funksion të një mbikëqyrjeje efektive që i përgjigjet në kohë dhe në cilësi kompleksitetit dhe zhvillimit të tregjeve.

- Të plotësojë kuadrin rregullator për të përmirësuar administrimin e rreziqeve të fondeve të investimeve, veçanërisht rrezikut të likuiditetit, vlerësimit të aseteve të tyre, sipas praktikave ndërkombëtare, si dhe të forcojë edukimin e investitorëve në skemat e investimeve kolektive.

- Të sigurojë që kompanitë të kenë politikat e tyre të menaxhimit të rrezikut dhe veprimtaria rregulluese dhe mbikëqyrëse e Autoritetit të riformatohet për t'iu përshtatur ndryshimit të profilit të rreziqeve të tyre.

- Të hartojë politika mbështetëse për zgjerimin e gamës së produkteve në fushën e sigurimeve vullnetare të jetës dhe jojetës, si dhe në fushën e pensioneve vullnetare, duke rritur ndërkohë edhe vetëdijësimin e punëdhënësve dhe punëmarrësve për të përdorur produktet që ofron tregu.

- Të rrisë ndërgjegjësimin e publikut, në bashkëpunim me kompanitë e sigurimit, në lidhje me produktet e sigurimit në sektorin e bujqësisë, sidomos për sigurimin nga ndikimi i motit.

- Të vazhdojë përmirësimet për të optimizuar funksionimin e faqes zyrtare *online*.

- Të monitorojë plotësimin e detyrimeve të shoqërive të sigurimit ndaj Byrosë, për financimin e Fondit të Kompensimit dhe ndjekjen e zbatimit të vendimeve për kryerjen e pagesave të dëmeve, objekt i këtij Fondi, në kohën e duhur.

- Të monitorojë dhe të auditojë procedurat e ndjekura nga shoqëritë e sigurimit për trajtimin e dëmeve të paguara dhe atyre të mbetura pezull, kryesisht dëmet në proces gjyqësor dhe dëmet e refuzuara.

- Të inkurajojë dhe të rrisë besimin e konsumatorit në rolin e AMF-së, nëpërmjet ngritjes së një kuadri bazë për parandalimin e abuzimeve në treg, dhe rritjes së efektshmërisë së funksioneve të AMF-së.

- Të kontribuojë në rritjen e qëndrueshmërisë financiare, nëpërmjet hartimit të kuadrit të masave për administrimin e situatave problematike në sistemin financiar në vend, në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF).

Miratuar në datën 14.5.2015